



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 12/08/2021 Ref.: 3016/21

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 87-të, të mbajtur më 07 dhe 27 Korrik 2021, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohen programet e studimit të Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2024:
 - Matematikë Financiare në Banka dhe Sigurime, BSc 180 ECTS, maksimumi 45 studentë për vit akademik.
 - Shkencë Kompjuterike, BSc, 180 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik.
 - Kimi, BSc, 180 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik.
 - Kimi Inxhinierike, BSc, 180 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik.
 - Kimi Fizike dhe Inorganike, MSc, 120 ECTS, maksimumi 15 studentë për vit akademik.
 - Kimi Analitike dhe Kimi Mjedisore, MSc, 120 ECTS, maksimumi 15 studentë për vit akademik.
 - Kimi Organike, MSc, 120 ECTS, maksimumi 15 studentë për vit akademik.
 - Biologji, BSc, 180 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik.
 - Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit, BSc, 180 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik.
 - Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit, MSc, 120 ECTS, maksimumi 30 studentë për vit akademik.
- II. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Fakulteti i Shkencave Matematike - Natyrore i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri më datë 15.11.2021 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.

IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Fakulteti i Shkencave Matematike - Natyrore i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelën e mëposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Programi i studimit</i>	<i>Bartësit e programit</i>
1	Matematikë Financiare në Banka dhe Sigurime, BSc 180 ECTS Ri-akreditim	Naim Braha Ejup Fejza Menderes Gashi
2	Shkencë Kompjuterike, BSc, 180 ECTS Ri-akreditim	Faton Berisha Ermir Rogova Armend Shabani
3	Kimi, BSc, 180 ECTS Ri-akreditim	Bashkim Thaçi Ramiz Hoti Hamit Ismajli
4	Kimi Inxhinierike, BSc, 180 ECTS Ri-akreditim	Ramë Vataj Fatmir Faiku Makfire Sadiku-Hasani Ilir Shehu
5	Kimi Fizike dhe Inorganike, MSc, 120 ECTS Ri-akreditim	Teuta Selimi Musaj Paçarizi Avni Berisha
6	Kimi Analitike dhe Kimi Mjedisore, MSc, 120 ECTS	Liridon Berisha Albana Mehmeti Albana Veseli
7	Kimi Organike, MSc, 120 ECTS	Majlinda Daci Arleta Rifati Miribane Dermaku
8	Biologji, BSc, 180 ECTS Ri-akreditim	Hazbije Sahiti Kimete Lluga-Rizani Kasum Letaj
9	Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit, BSc, 180 ECTS	Halil Ibrahimimi Elez Krasniqi Kemajl Kurteshi
10	Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit, MSc, 120 ECTS	Avni Hajdari Linda Grapci

Çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, duhet të raportohet dhe arsyetohet në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar duhet të aprovohet nga KSHC.

AKA ka organizuar dy vizita me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Shkencave Matematike - Natyrore Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit.

Vizitat janë organizuar më 08.04.2021 dhe me 17.05.2021, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Antonio Sanchez Pozo, Ivan Slapničar, Mladen Krajačić, Peeter Normak, Sanja Kalambura, Domagoj Vugić, Herbert Stori dhe Jadranka Pelikan.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit, dhe për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:


1. Për programin e studimit Matematikë Financiare në Banka dhe Sigurime, BSc 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht katër (4), pjesërisht dy (2).
2. Për programin e studimit Shkencë Kompjuterike, BSc, 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht katër (4), pjesërisht tri (3).
3. Për programin e studimit Kimi, BSc, 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht pesë (5), ndërsa i përmbush pjesërisht dy (2).
4. Për programin e studimit Kimi Inxhinierike, BSc, 180 ECTS nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht katër (4), pjesërisht tri (3).
5. Për programin e studimit Kimi Fizike dhe Inorganike, MSc, 120 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht gjashtë (6), ndërsa pjesërisht një (1).
6. Për programin e studimit Kimi Analitike dhe Kimi Mjedisore, MSc, 120 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht pesë (5) dhe pjesërisht dy (2).
7. Për programin e studimit Kimi Organike, MSc, 120 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht pesë (5) dhe pjesërisht dy (2).
8. Për programin e studimit Biologji, BSc, 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht shtatë (7).
9. Për programin e studimit Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit, BSc, 180 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht gjashtë (6), ndërsa pjesërisht një (1).
10. Për programin e studimit Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit, MSc, 120 ECTS, nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht pesë (5) dhe pjesërisht dy (2).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 87 të mbajtur më 07. 07. 2021 dhe 27.07.2021 ka shqyrtuar aplikacionin e Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakultetit të Shkencave Matematike - Natyrore;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

